

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**SOCIAL MEDIA MANAGEMENT**

Sot, më datë 03.02.2022, personalisht:

- **Bledian PERONA**, i biri i Refat-it, i datëlindjes 07.10.1989, shtetas shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Rr. Leon Rei, Fier, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare Social Media Management Sh.p.k.

Përpilon këte akt themelimi të shoqërisë tregtare **SOCIAL MEDIA MANAGEMENT sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojë Shoqërinë Tregtare SOCIAL MEDIA MANAGEMENT SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri SOCIAL MEDIA MANAGEMENT SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit SOCIAL MEDIA MANAGEMENT SH.P.K dhe me emrin tregtar S.M.M. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Mirëmbajtja dhe menaxhimi i rrjeteve sociale dhe kërkime të informacionit online për llogari të tretëve.

**NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Sulejman Delvina, Pass.Nr.2/363+1-19, Nj.Administrative 5, Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.



## **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar eshte 100.000 ( njeqind mije ) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

## **NENI 7**

Ortaku i vetem themelues i Shoqërisë Tregtare SOCIAL MEDIA MANAGEMENT Sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Bledian PERONA: pjesemarrja ne perqindje 100 %, 1 kuotë, lloji i kontributit ne para, 100.000 ( njeqindmije ) Leke.

## **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Bledian Refat PERONA**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 10**

Oratku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## **NENI 11**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.



## **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

### **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**Bledian PERONA**

Bledian Perona 